

2030

Ëndërr apo realitet?!



RAPORT MONITORIMI

Korrik 2025



QENDRESA
QYTETARE



NED NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

**AUTOR
LORELA ALIA**

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1.	HYRJE	3
2.	METODOLOGJIA E PUNËS	4
3.	SFONDI HISTORIK I INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË.....	5
4.	VLERËSIMI I KAPITULJVE TË NEGOCIATAVE.....	9
4.1	Grupkapitulli i themelorëve	11
4.2	Grupkapitulli i tregut të brendshëm	12
4.3	Grupkapitulli i konkurrueshmërisë dhe rritjes përfshirëse	13
4.4.	Grupkapitulli i agjendës së gjelbër dhe lidhshmërisë së qëndrueshme	13
4.5	Grupkapitulli i burimeve, bujqësisë dhe kohezionit	15
5.	KRAHASIMI I VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR NË PROCESIN E ANËTARËSIMIT NË BE	15
6.	FAKTORËT QË NDIKOJNË PROCESIN E INTEGRIMIT.....	18
7.	Analiza e skenarëve për peridhën 2027-2030	24
7.	GJETJET KRYESORE	27
8.	REKOMANDIMET.....	29
	REFERENCAT	30

1. HYRJE

Që nga fillimi i viteve 1990, integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian ka qënë një aspiratë e qëndrueshme shoqërore dhe një objektiv strategjik kombëtar.

Së pari le të shpjegojmë një koncept të rëndësishëm të këtij raporti që ka të bëjë me Integrimin Evropian, që përfshin transferimin e një pjese të sovranitetit kombëtar tek institucionet e BE-së.¹ Ideologjikisht, zgjerimi ka të bëjë me integrimin dhe konsolidimin politik, socio-ekonomik dhe territorial të Bashkimit Evropian, duke çuar kështu përpara idenë dhe projektin e Evropës. Ndërsa, në një qasje më praktike, politikat e zgjerimit janë të dobishme për stabilizimin e rajonit dhe sigurimin e sigurisë evropiane.²

Entuziazmi qytetar për anëtarësimin në Bashkimin Evropian ka mbetur pothuajse i pandryshuar për tri dekada, ndërsa dinamika e brendshme politike shpesh e ka trajtuar këtë synim më tepër si mjet retorik sesa si prioritet të mirëfilltë qeverisës. Hapat e Shqipërisë drejt BE-së kanë qënë të ngadaltë. Zyrtarisht Shqipëria aplikoj për t'u anëtarësuar në vitin 2009, por për të hapur negociatat i duhej të priste 13 vite. Në vitin 2022 Shqipëria mori dritën jeshile për hapjen e negociatave, por pas këtij hapi proceduror, Konferenca Ndërqeveritare për çeljen e grupkapitullit të parë (Cluster 1) u mbajt "de facto" më 15 tetor 2024, duke e kaluar procesin nga faza fillestare në atë substanciale të negociatave.

Megjithatë, polarizimi i skajshëm partiak, kapacitetet ende të brishta administrative dhe nivelet e larta të korrupsionit vazhdojnë të ngadalësojnë përparimin, duke rrezikuar që integrimi të mbetet një premtim i papërbushur. Fushata zgjedhore e majit 2025 e riktheu

¹ Guyader, M. (2007), "Élargissements et intégration dans l'Union. ", *Politique étrangère*, (2), p.372.

² *Élargissement de l'UE*. (2022, 25 juin). European Council

<https://www.consilium.europa.eu/fr/policies/enlargement/#:%7E:text=Qu'est%2Dce%20que%20l,de%20conditions%20politiques%20et%20C3%A9conomiques.>

integrimin në qendër të diskursit publik, kur Kryeministri artikuloi objektivin që Shqipëria do të mbyllë negociatat në vitin 2027 dhe do të bëhet anëtare me të drejta të plota deri në vitin 2030. Në planin diplomatik, një afat i tillë do ta vendoste vendin ndër përpjekjet më të shpejta të zgjerimit ndërsa në planin praktik, ai nënkupton mbylljen e dhjetëra kapitujve negociues, shtrirjen reale të “acquire communautaire” në të gjitha sektorët dhe konsolidimin e institucioneve të reja gjyqësore, një agjendë sfiduese edhe për shtete me kapacitete më të zhvilluara.

Pyetja kryesore që shtrojmë në kuadër të këtij raporti është: “Sa reale dhe e mundshme është mbyllja e negociatave deri në vitin 2027 dhe anëtarësimi i plotë i Shqipërisë në Bashkimin Evropian deri në vitin 2030, duke u bazuar në progresin e deritanishëm dhe sfidat që mbeten për t’u përmbushur?”

Ky raport synon të vlerësojë sa reale është kjo ambicie. Duke u mbështetur në raportet e Komisionit Evropian, të dhënat krahasuese me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe indikatorët ndërkombëtare do të analizohet progresi i deritanishëm, boshllëqet që duhen kapërcyer dhe skenarët e mundshëm deri në 2030-en. Nëse reforma në drejtësi, lufta kundër korrupsionit dhe drejtimi ekonomik i vendit do të vijojnë me të njëjtin intensitet, Shqipëria mund t’i afrohet kuotës minimale të standardeve evropiane, në të kundërtën, afati i premtuar rrezikon të mbetet një premtim eloktoral i radhës. Në këtë mënyrë, raporti ofron jo vetëm një panoramë të situatës aktuale, por edhe një projeksion për vitin 2027-2030.

2. METODOLOGJIA E PUNËS

Ky raport kërkimor do të bazohet në një qasje cilësore dhe krahasuese për të analizuar realisht mundësinë e anëtarësimit të Shqipërisë në

Bashkimin Evropian deri në vitin 2030.

Metodat kryesore të përdorura janë:

- Analiza dokumentare: Shqyrtohen burime zyrtare si raportet e progresit të Komisionit Evropian, dokumente strategjike të BE-së dhe të qeverisë shqiptare, si dhe vlerësime të organizatave ndërkombëtare mbi progresin demokratik, institucional dhe ekonomik. Për secilin kapitull, niveli i përgatitjes do të vlerësohet me një notë nga 1 në 5, duke u mbështetur në metodologjinë dhe notat udhëzuese që Komisioni Evropian përdor në Raportin e Progresit për Shqipërinë.
- Krahasimi me Ballkanin Perëndimor (benchmarking): për të krahasuar ecurinë e Shqipërisë me shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor që ndodhen në faza të ndryshme të procesit të integritetit.
- Analizë e skenarëve të mundshëm: tre skenarë të zhvillimit të mundshëm deri në vitin 2027: optimist, realist dhe pesimist.

Kjo metodologji synon të sigurojë një kuptim të thelluar dhe të ekuilibruar mbi ecurinë e Shqipërisë në raport me pritshmëritë e BE-së dhe realitetin rajonal.

3. SFONDI HISTORIK I INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË

Negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) ishin parashikuar të nisin në fund të vitit 2002, por u shtynë për shkak të vështirësive të Shqipërisë në sigurimin e stabilitetit politik dhe në

zbatimin e reformave. Marrëveshja u nënshkrua më 16 qershor 2006 në Tiranë dhe hyri në fuqi në vitin 2009. Më 28 prill 2009 Shqipëria dorëzoi zyrtarisht kërkesën për anëtarësim në Bashkimin Evropian³.

Në vitin 2010, Komisioni Evropian e refuzoi statusin e kandidatit, duke theksuar se vendi nuk kishte përmbushur ende kriteret politike të Kopenhagenit, veçanërisht stabilitetin institucional, demokracinë dhe sundimin e ligjit⁴. Qeverisë shqiptare iu paraqitën 12 rekomandime kyçe për t'u plotësuar përpara se të rishqyrtohej statusi.

Një hap përpara ishte liberalizimi i vizave në dhjetor 2010, i cili lehtësoi udhëtimin pa viza të qytetarëve shqiptarë në zonën Shengen. Në tetor 2012, Komisioni rekomandoi dhënien e statusit të kandidatit, me kusht përfundimin e reformave kryesore në drejtësi dhe administratë publike. Këshilli Evropian ia akordoi zyrtarisht Shqipërisë këtë status në qershor 2014, duke njohur progresin e deritanishëm dhe duke hapur rrugën drejt negociatave të pranimit.

Për të kaluar në fazën e negociatave, vendi duhej të përmbushte pesë prioritetet bazë⁵:

1. krijimin e një administrate publike profesionale dhe të depolitizuar;
2. forcimin e pavarësisë së gjyqësorit;
3. luftën kundër korrupsionit;
4. luftën kundër krimit të organizuar;
5. mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në mars 2020 Këshilli miratoi metodologjinë e re të zgjerimit, e cila i organizon 33 kapitujt e acquis-it në gjashtë "cluster" tematike dhe vendos në qendër 'Themelorët' shtetin e së drejtës, kriteret ekonomike

³ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (2020). Marrëdhëniet Shqipëri-BE <http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/anetaresimi-ne-be/historiku/>

⁴ Commission Européenne (2010). Avis de la Commission sur la demande d'adhésion de l'Albanie à l'Union européenne, Bruxelles, le 9.11.2010 COM(2010) 680 final

⁵ European Commission (2014). Communication on EU Enlargement Policy- Albania 2014 Report. COM(2014)700 final of 8.10.2014.

dhe reformën e administratës publike.⁶ Hapja e çdo grupi tjetër kushtëzohet nga përparimi i matshëm në këtë bllok bazë. Kjo qasje e bën procesin më teknik dhe më sfidues: një kapitull i mbyllur provizorisht mund të rihapet nëse vendi bën hapa pas, ndërsa parimi i kthyeshmërisë i jep BE-së të drejtën të pezullojë ose të kthejë prapa fazat negociuese derisa standardet të rikuperohen.

Raporti i Komisionit Evropian 2019-2020 konstatoi se Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kishin plotësuar kushtet për konferencën e parë ndërqeveritare. Megjithatë, vetoja dy-vjeçare e Bullgarisë ndaj Shkupit bllokoi indirekt progresin e Tiranës deri në vitin 2022. Për të shmangur më tej vonesat, BE-ja vendosi t'i trajtojë dy vendet të ndara.

Konferenca e parë Ndërqeveritare për "Cluster 1" u mbajt më 15 tetor 2024, duke shënuar fillimin zyrtar të zbatimit të kapitujve të negociatave.⁷ Pas saj:

- në dhjetor 2024 u hap grupkapitulli 6 për Politikën e Jashtme,
- në prill 2025 u hap grupkapitulli 2 "Tregu i Brendshëm",
- në maj 2025 u hap grupkapitulli 3 "Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse".

Në total, Shqipëria ka hapur katër grupkapituj, ndërsa mbeten ende të paçelur:

- "Agjenda e Gjelbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme",
- "Bujqësia, Burimet dhe Kohezioni".


Këto hapa ilustrojnë progresin e Shqipërisë në rrugën drejt anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian dhe nënvizojnë domosdoshmërinë e përfundimit me sukses të reformave të mbetura. Megjithëse kapitujt negociues janë hapur brenda një periudhe relativisht të shkurtër dhe

⁶ European Commission. (2020, 5 shkurt). *Enhancing the accession process – A credible EU perspective for the Western Balkans* (COM(2020) 57 final). Brussels. (eur-lex.europa.eu)

⁷ Cluster 1 Albania – Cluster One EU Negotiations Platform – Albania (C1-EU-NPA). (n.d.). <https://cluster1albania.com/>

mbyllja e tyre kërkon ritme edhe më të shpejta. Procesi nuk kufizohet vetëm te transpozimi formal i legjisllacionit të BE-së, sfida kryesore mbetet përafrimi praktik me standardet evropiane dhe përmbushja e plotë e kriterëve të përcaktuara nga benchmark përkatëse.

Figura 1. Procesi i integritit të Shqipërisë në BE (2006-2025)



Burimi: Faqja zyrtare e BE-së

4. VLERËSIMI I KAPITUJVE TË NEGOCIATAVE

Për vlerësimin e nivelit të përgatitjes së secilit kapitull, do t'i klasifikojmë në një shkallë nga 1 deri në 5, si më poshtë:

1 = fazë e hershme e përgatitjes

2 = njëfarë përgatitjeje

3 = përgatitje mesatare

4 = përgatitje e mirë

5 = përgatitje e avancuar

Tabela 1. Progresi i Shqipërisë në Negociatat me BE

Klasi	Kapitulli	Progresi sipas Raportit 2020 ⁸	Progresi sipas Raportit 2021 ⁹	Progresi sipas Raportit 2022 ¹⁰	Progresi sipas Raportit 2023 ¹¹	Progresi sipas Raportit 2024 ¹²	Hapja & Data
1: Themelorët	5. Prokurimi publik	3	3	3	3	3	Po (15.10.2024)
	18. Statistikat	3	3	3	3	3	Po (15.10.2024)
	23. Sistemi gjyqësor dhe të drejtat themelore	2	2	2.5	2.5	3	Po (15.10.2024)
	24. Drejtësia, liria dhe siguria	2	2	2.5	2.5	3	Po (15.10.2024)
	32. Kontrolli financiar	3	3	3	3	3	Po (15.10.2024)
2: Tregu i Brendshëm	1. Lëvizja e lirë e mallrave	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5	Po (14.04.2025)
	2. Lëvizja e lirë e punëtorëve	2	2	2	2	2	Po (14.04.2025)
	3. E drejta e vendosjes dhe shërbimet	3	3	3	3	3	Po (14.04.2025)
	4. Lëvizja e lirë e kapitalit	3	3	3	3	3	Po (14.04.2025)
	6. E drejta e shoqërive	3	3	3	3	3	Po (14.04.2025)
	7. Të drejtat e pronës intelektuale	2.5	2.5	2.5	3	3	Po (14.04.2025)

⁸ European Commission (2020). Communication on EU Enlargement Policy- Albania 2020 Report. Brussels, 6.10.2020 SWD(2020) 354 final

⁹ European Commission (2021). Communication on EU Enlargement Policy- Albania 2021 Report. Strasbourg, 19.10.2021 SWD(2021) 289 final

¹⁰ European Commission (2022). Communication on EU Enlargement Policy- Albania 2022 Report. Brussels, SWD(2020) 332 final

¹¹ European Commission (2023). Communication on EU Enlargement Policy- Albania 2023 Report. Brussels, SWD(2020) 690 final

¹² European Commission (2024). Communication on EU Enlargement Policy- Albania 2024 Report. Brussels, SWD(2020) 690 final

	8. Politika e konkurrencës	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5	Po (14.04.2025)
	9. Shërbimet financiare	3	3	3	3.5	3.5	Po (14.04.2025)
	28. Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit	1	1	1	1	1	Po (14.04.2025)
3: Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse	10. Transformimi digjital dhe mediat	3	3	3	3	3.5	Po (22.05.2025)
	16. Tatimet	3	3	3	3	3	Po (22.05.2025)
	17. Politika ekonomike dhe monetare	3	3	3	3	3.5	Po (22.05.2025)
	19. Politika sociale dhe punësimi	2	2	2	3	3	Po (22.05.2025)
	20. Politika e ndërmarrjeve dhe industriale	3	3	3	3	3.5	Po (22.05.2025)
	25. Shkenca dhe kërkimi	1	2	2	2	2	Po (22.05.2025)
	26. Arsimi dhe kultura	3	3	3	3	3	Po (22.05.2025)
	29. Bashkimi doganor	3	3	3	3	3	Po (22.05.2025)
4: Axhenda e gjelbër dhe lidhjet e qëndrueshme	14. Politika e transportit	2	2	2	2	2	Jo
	15. Energjia	3	3	3	3.5	3.5	Jo
	21. Rrjetet trans-evropiane	2	2	2	2	2	Jo
	27. Mjedisi	2	2	2	2	2	Jo
5: Bujqësia, burimet dhe kohezioni	11. Bujqësia dhe zhvillimi rural	2	2	2	2	2	Jo
	12. Siguria ushqimore, politika veterinare dhe fitosanitare	2	2	2	2	2	Jo
	13. Peshkimi	1	2	2.5	3	3	Jo
	22. Politika rajonale dhe kohezioni	3	3	3	3	3	Jo
	33. Dispozitat financiare dhe buxhetore	2	2	2	2	2	Jo
6: Marrëdhëniet me jashtë	30. Marrëdhëniet e jashtme	3	4	4	4	4	Po (17.12.2024)
	31. Politika e jashtme, e sigurisë dhe mbrojtjes	4	4	4	4	4	Po (17.12.2024)

Shqipëria ka hapur tashmë katër nga gjashtë grupkapitujt tematikë të metodologjisë së re të negociatave dhe pret të çelë dy të fundit brenda vitit 2025. Megjithëse vlerësimet e Komisionit European dëshmojnë përparim të qëndrueshëm në periudhën 2020 – 2024, ritmi mbetet modest, shumica e kapitujve vijojnë të vlerësohen me nota 2 (njëfarë përgatitje) ose 3 (përgatitje mesatare), me një përmirësim mesatar prej vetëm 0,5 pikësh në pesë vjet. Përfundimisht bën Grupkapitulli 6 Politika e Jashtme dhe Siguria, i cili renditet me notën 4 (përgatitje e mirë), falë përputhjes së qëndrueshme me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë së BE-së dhe rolit konstruktiv të Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor. Grupkapitujt ku Shqipëria evidentohet me nivelin më të ulët të përgatitjes janë Grupkapitulli 4, “Afhenda e gjelbër dhe lidhjet e qëndrueshme” dhe Grupkapitulli 5, “Bujqësia, burimet dhe kohezioni”. Të dyja këto fusha, ende të paçelura, vlerësohen nga Komisioni me “njëfarë përgatitje”, (me notën 2 nga 5 Tabela 1) duke dëshmuar se progresi mbetet në fazë fillestare. Nisur nga kjo situatë, analiza e mëposhtme përqëndrohet në pesë grupkapitujt ku sfidat strukturore mbeten të mprehta, përveç Grupkapitullit 6 “Politika e Jashtme dhe e Sigurisë”, i cili tashmë renditet me përgatitje të mirë.¹³

4.1 Grupkapitulli i themelorëve¹⁴

Në çdo proces zgjerimi, Komisioni nisat nga premisa se demokracia funksionale dhe shteti i së drejtës janë parakusht për avancim. Vetting-u ka ndryshuar historikun gjyqësor të vendit, ku 98% e dosjeve të nivelit të parë janë mbyllur, por sfida reale mbetet konsolidimi i rezultateve, përmbjllja në apel, parandalimi i rikthimit të figurave të diskredituara dhe krijimi i mekanizmave që garantojnë imunitet institucional ndaj ndërhyrjeve politike.¹⁵ Pa këtë të fundit, kompromisi i brishtë mes palëve politiko-gjyqësore mund të zhbëhet me çdo rotacion pushteti.

¹³ European Commission (2024). Communication on EU Enlargement Policy- Albania 2024 Report. Brussels, SWD(2020) 690 final

¹⁴ Ibid.

¹⁵ Ibid.

Nga ana tjetër, polarizimi i Kuvendit, materializuar në bojkote, përplasje fizike dhe bllokim të ligjbërjes, minon logjikën e kontroll-balancave. Një parlament që dëmton vetë legjitimitetin e tij nuk mund të ushtrojë mbikëqyrje efektive ndaj qeverisë, prandaj ky grupkapitull mbetet sfida me e madhe për Shqipërinë, pa një kulturë politike bashkëpunuese, implemantimi i legjislacionit dhe kushtet teknike në letër nuk prodhojnë rezultate reale.

4.2 Grupkapitulli i tregut të brendshëm

Harmonizimi ligjor në lexim të parë duket si proces Teknik, i cili miraton një ligj mbi akreditimin e produktit dhe zgjidh punë. Në praktikë, Shqipëria ballafaqohet me një treg ku informaliteti, monopoli “de facto” dhe klientelizmi janë dëshmi të fuqisë së interesave të veçanta mbi vendimmarrje arbitrare shtetërore. Mungesa e transparencës në tenderime e përkeqësuar nga përjashtime “të përkohshme” nga ligji dhe krijon jo vetëm risk për korrupsion, por ul investimet e huaja.

Kapitulli 28, që mbulon mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetin publik, vazhdon të jetë hallka më problematike e Shqipërisë në grup-kapitullin e Tregut të Brendshëm. Komisioni Evropian e ka renditur pesë vite radhazi “në fazë të hershme përgatitjeje”, duke vërejtur mungesë të plotë progresi në 2020-2021 dhe vetëm “progres të kufizuar” gjatë 2022-2024. Vonesat lidhen me harmonizimin e pjesshëm të ligjit për mbrojtjen e konsumatorit me legjislacionin evropian, si dhe me mungesën e mekanizmave të fuqishëm të zbatimit dhe buxheteve adekuate për autoritetet përgjegjëse. Kapacitetet inspektuese dhe Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit mbeten të paktë në staf, ndërsa nuk janë krijuar ende strukturat që mundësojnë lidhjen me sistemin Safety Gate dhe trajtimin efektiv të ankesave. Për të kaluar nga “fazë fillestare” në një nivel më të avancuar, kërkohet miratimi i të gjithë akteve nënligjore, rritje e fondeve për vëzhgimin e tregut dhe zbatimimi i plotë i mekanizmave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve. Ndryshe, ngecja në këtë kapitull rrezikon të pengojë mbylljen në kohë

të të gjithë klasterit të brendshëm dhe të zvarritë afatet e përgjithshme të negociatave me BE-në.

4.3 Grupkapitulli i konkurrueshmërisë dhe rritjes përfshirëse¹⁶

Evidenca e raportit shfaq një paradoks, rritja ekonomike është e qëndrueshme (turizmi dhe investimet kanë mbajtur ritmin), por produktiviteti dhe ndërmarrjet inovative mbeten të kufizuara. Këtu ndërthuren tri hallka:

1. Sistemi fiskal ende i fragmentuar lejon shkallë të lartë evazioni si dhe mungesa e strategjisë së të ardhurave.
2. Inovacioni, financimi publik për kërkim dhe shkencë (Research & Science) vazhdon të jetë nën 0.3 % të PBB-së, niveli më i ulët në krahasim vendet e rajonit dhe shumë larg me vendet e BE-së.
3. Përfshirja sociale, garancia rinore pilot dhe fondi social është larg nga nevojat reale, veçanërisht në zonat rurale.

Pa kapital njerëzor të formuar, pa disiplinë fiskale që mobilizon të ardhura dhe pa inovacioni, Shqipëria do të jetë konkurruese në kosto, por jo në vlerë të shtuar.

4.4 Grupkapitulli i agjendës së gjelbër dhe lidhshmërisë së qëndrueshme

Komisioni Evropian vlerëson se Shqipëria ka “disa nivel përgatitjeje” (nota 2 nga 5) në kapitullin 14 për politikën e transportit, me “progres të kufizuar” gjatë periudhës 2020-2024. Vendi ende s’ka miratuar Strategjinë e re Kombëtare të Transportit 2021-2025 dhe planin shoqërues të sigurtisë rrugore, gjë që e pengon plotësimin e objektivave të Traktatit të Komunitetit të Transportit (TCT).

Në energji vendi meriton vlerësim si pjesë e tregut rajonal, reforma në tregun e brendshëm të energjisë dhe objektiv për ndërprerjen e

¹⁶ European Commission (2024). Communication on EU Enlargement Policy- Albania 2024 Report. Brussels, SWD(2020) 690 final

varësisë nga hidrokarburet, por përparimi në energji bie ndesh me performancën mjedisore.

Amendamentet e miratuara nga Parlamenti në shkurt 2024 për Ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” i hoqën mbrojtjen e rreptë shumë teritoreve natyrore duke futur tri ndryshime kyçe:

1. Kategorizuan ndërtimet turistike, energjetike dhe infrastrukturore si “veprimtari me interes publik”, ç’ka u lejon të zhvillohen brenda çdo kategorie parku;
2. Ia kaluan kompetencën kryesore vendimmarrëse Këshillit Kombëtar të Territorit (të kryesuar nga kryeministri), duke anashkaluar autoritetin për mbrojtjen e natyrës dhe konsultimet publike;
3. Zbutën kriteret për vlerësimin e ndikimit në mjedis (EIA), duke i bërë ato fakultative për investime strategjike. Për rrjedhojë, ligji perceptohet si “green-lighting” për resortet luksoze, aeroporte si Divjaka-Karavasta, Karaburun-Sazan apo delta e Vjosës. Komisioni Evropian e cilësoi miratimin “zhvillim negativ” që rrezikon përputhshmërinë “acquire communautaire” të BE-së për natyrën dhe biodiversitetin, ndërsa organizatat mjedisore paralajmërojnë se ndryshimet hapin derën për “zhveshje” të statusit të mbrojtur të rreth 800,000 ha tokë.¹⁷ Kjo nuk është thjesht çështje harmonizimi teknik, por është sfidë identitare. A do të ndjekë Shqipëria modelin e rritjes së shpejtë në kurriz të ekosistemeve, apo do të ripozionohet si ofrues i turizmit të qëndrueshëm?

Ky grupkapitulli ende nuk është hapur kjo tregon se Shqipëria duhet të intensifikojë përpjekjet për të përmbushur kriteret e nevojshme në këtë fushë.

¹⁷ European Commission (2024). Communication on EU Enlargement Policy- Albania 2024 Report. Brussels, SWD(2020) 690 final

4.5 Grupkapitulli i burimeve, bujqësisë dhe kohezionit¹⁸

Sektori bujqësor është paradoksi ekonomik i Shqipërisë, punëson një të tretën e forcës së punës, por kontributi në PBB është nën 20%. Ndërkohë, kapitulli 12 (siguria ushqimore) shfaq një skenar edhe më kritik, mungesa e harmonizimit me “acquire communautaire”, struktura veterinare në numër të ulët, të pakualifikuara dhe kontrole sanitare të pjesshme ngrenë dyshime të drejta mbi sigurinë e zinxhirit ushqimor. Të shumta kanë qënë skandalet në lidhje me ushqimet rasti më i zëshëm ishte me kontaminimin me salmonelë të filetos së pulës. Në tregun e vetëm të BE-së, një skandal ushqimor nuk mbetet fenomen lokal, ai përhap pasiguri në të gjithë bllokun dhe sjell pasoja të rënda ekonomike.

Në anën e kohezionit rajonal, Shqipëria sapo ka nisur të formësojë arkitekturën e strukturave IPA III, pa një strategji të qartë për zhvillimin rajonal dhe pa personel të kualifikuar për auditimin e fondeve, rreziku i pezullimit të projekteve mbetet real.

5. KRAHASIMI I VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR NË PROCESIN E ANËTARËSIMIT NË BE

Në kontekstin e integritit evropian, vendet e Ballkanit Perëndimor paraqesin nivele të ndryshme progresi në procesin e aderimit në Bashkimin Evropian, duke reflektuar dinamikat e brendshme politike, ekonomike dhe sociale, si dhe sfidat e veçanta rajonale.

Shqipëria, që ka nisur negociatat në korrik të vitit 2022, aktualisht ka hapur 24 kapituj negociues, megjithatë ende nuk ka arritur të mbyllë asnjë prej tyre.¹⁹ Vendi ka realizuar hapa të rëndësishëm në drejtësi, duke zbatuar një reformë të thellë dhe komplekse dhe ka investuar

¹⁸ Ibid.

¹⁹ Rreth negociatave - Integrimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. (2020, May 5). Integrimi I Republikës Së Shqipërisë Në Bashkimin Evropian. <https://integrimi-ne-be.punetejashme.gov.al/negociatat/reth-negociatave/>

ndjeshëm në digjitalizimin e administratës publike. Megjithatë, korrupsioni dhe efikasiteti i institucioneve mbeten sfida kritike që kërkojnë zgjidhje të mëtejshme.

Në mënyrë të ngjashme, Maqedonia e Veriut filloi negociatat në të njëjtën kohë si Shqipëria, në korrik 2022, por ende nuk ka hapur asnjë kapitull negociues. Përparimi më i rëndësishëm i Maqedonisë së Veriut lidhet me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve historike me Greqinë, që ishte pengesë kyçe për integrimin evropian. Megjithatë, marrëdhëniet komplekse me Bullgarinë dhe sfidat e vazhdueshme të emigracionit e pengojnë përparimin e saj në procesin e negociatave.²⁰

Mali i Zi dhe Serbia kanë arritur progres më të avancuar në negociatat me Bashkimin Evropian. Mali i Zi, me negociata të hapura që nga qershori 2012, ka hapur 33 kapituj, nga të cilët ka mbyllur 7, duke dëshmuar kështu një përparim teknik të konsiderueshëm dhe stabilitet relativ të institucioneve shtetërore. Serbia, që ka filluar negociatat në janar të vitit 2014, ka hapur 22 kapituj dhe ka arritur të mbyllë 2 prej tyre. Përmirësimet ligjore dhe ekonomia funksionale janë arritjet më të spikatura, por marrëdhëniet e tensionuara me Kosovën dhe problematikat lidhur me lirinë e medias vazhdojnë të jenë sfida të mëdha që frenojnë integrimin e plotë.

Bosnje-Hercegovina mbetet ende larg fillimit formal të negociatave, edhe pse ka statusin e vendit kandidat. Sfidat kryesore që vështirësojnë këtë proces janë struktura komplekse politike e vendit, si dhe tensionet etnike që krijojnë paqëndrueshmëri dhe mungesë konsensusi për reforma thelbësore. Në fund, Kosova është në fazën më fillestare, duke pasur vetëm statusin e vendit potencial kandidat, pa filluar ende negociata. Liberalizimi i vizave në vitin 2024 shënon një hap të

²⁰ Koutsokosta, E. (2021, 11 maj). *Splitting EU membership bids of North Macedonia and Albania « not possible »*. Euronews. <https://www.euronews.com/my-europe/2021/05/10/not-possible-to-decouple-eu-bids-of-north-macedonia-and-albania-says-zaev>

rëndësishëm, por fakti që disa shtete anëtare të BE-së ende nuk e njohin Kosovën mbetet pengesa kryesore në rrugën drejt integritimit.

Në përgjithësi, rruga drejt Bashkimit Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor karakterizohet nga sfida të ngjashme, si lufta kundër korrupsionit dhe përmirësimi i qeverisjes, por dinamika individuale dhe sfidat specifike përcaktojnë ritmet dhe sukseset e ndryshme në këtë proces integruar.

Tabela 2. Vendet e Ballkanit Perëndimor në procesin e integritimit në BE.

Vendi	Statusi në BE	Hapja e negociatave	Kapituj të hapur	Kapituj të mbyllur	Përparime kryesore	Sfidat kryesore
Shqipëria	Vende Kandidate (negociata aktive)	Korrik 2022 2024 hapja e grupkapitullit të parë	24	0	Reforma në drejtësi, dixhitalizimi i administratës	Korrupsioni, efikasiteti i institucioneve
Maqedonia e Veriut	Vende Kandidate	Korrik 2022	0	0	Marrëveshja e Greqin, përkushtim ndaj BE	Çështje me Bullgarinë, emigrimi
Mali i Zi	Vende Kandidate (negociata të avancuara)	Qershor 2012	33	7	Institucione të qëndrueshme, përparim teknik	Kriza politike të brendshme
Serbia	Vende Kandidate (negociata të avancuara)	Janar 2014	22	2	Ekonomi funksionale, përmirësime në ligje	Marrëdhëniet me Kosovën, liria e medias

Bosnje-Hercegovina	Vende Kandidate (ende pa negociata)	Ende jo	0	0	Disa reforma administrative	Strukturë e ndërlikuar politike, tensione etnike
Kosova	Kandidate Potenciale	Ende jo	0	0	Liberalizimi i vizave (2024)	Mungesa e njohjes nga disa shtete të BE-së

Burimi: Fact sheets on the EU

6. FAKTORËT QË NDIKOJNË PROCESIN E INTEGRIMIT

Procesi i integritimit të Shqipërisë në Bashkimin European është formësuar nga një bashkëveprim i ndërlikuar faktorësh të brendshëm që lidhen me funksionimin e shtetit shqiptar dhe faktorësh të jashtëm, që burojnë nga dinamika e politikave të zgjerimit dhe nga vetë sfidat e brendshme të BE-së.

Në planin e brendshëm, politika mbetet vektori i parë përcaktues. Përtej 33 kapitujve të "acquis communautaire", BE-ja kërkon përmbushjen e dy kriterëve horizontale: konsolidimin e demokracisë dhe reformën e administratës publike. Shqipëria ka bërë hapa përpara, por me ritëm të ngadaltë. Indeksi i "The Economist" e klasifikoi vendin si "demokraci me të meta"²¹ pas daljes nga kategoria "regjim hibrid" në vitin 2020, ndërsa "Freedom House" vijon ta rendisë "pjesërisht të lirë", pa shenja përmirësimi në pesë vitet e fundit.²² Dobësitë institucionale, polarizimi dhe një opozitë e pafuqishme i japin avantazh disproporcional Partisë Socialiste dhe kufizojnë kontrollin parlamentar. Këto dinamika kulmuan me protestat e dhunshme të nëntorit 2024 dhe me zgjedhjet e majit 2025, që OSBE/ODIHR-i i vlerësoi të dominuara nga

²¹ TRADING ECONOMICS. (n.d.). *Albania Corruption Index*.
<https://tradingeconomics.com/albania/corruption-index>

²² Freedom House. (n.d.). *Albania*. In *Freedom House*.
<https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2024>

keqpërdorimi i burimeve shtetërore, presion ndaj votuesve dhe mbulim mediatik të njëanshëm.²³

Administrata publike vijon të jetë e politizuar, me kapacitete të kufizuara për të përthithur dhe menaxhuar fondet IPA. Mungesa e transparencës dhe e llogaridhënies ka gërryer besimin e partnerëve europianë, duke bërë që zbatimimi i projekteve të varet gjithnjë e më shumë nga monitorimi i jashtëm.

Korrupsioni dhe kapja e shtetit paraqesin pengesën më të madhe strukturore. Shqipëria renditet e 80-ta ndër 180 vende në indeksin e "Transparency International" (2024), larg mesatares së BE-së. Këto fenomene frenojnë kapitujt 23 dhe 24, pavarësisht nisjes së reformës në drejtësi, e cila ecën me ritëm të ngadaltë dhe ende nuk ka prodhuar rezultate të prekshme në ndëshkrimin e korrupsionit të nivelit të lartë.²⁴

Sfida të tjera të brendshme burojnë nga struktura ekonomike, borxhi publik i lartë, papunësia dhe niveli relativisht i ulët i zhvillimit, që e bëjnë integrimin ekonomik një sfidë të dyfishtë. Vendi duhet të përshtatet me rregullat e tregut të përbashkët dhe njëkohësisht, të garantojë konkurrueshmëri për bizneset dhe siguri sociale për qytetarët..

Faktorët e jashtëm kompleksojnë më tej panoramën. Pas zgjerimeve të 2004-s dhe 2007-s, BE-ja ka shfaqur "lodhje nga zgjerimi". Krizat e eurozonës, migracionit, Brexit-it, pandemia COVID-19 dhe agresioni rus në Ukrainë kanë rritur koston politike të çdo anëtarësimi të ri. Në mandatin 2024-2029, Parlamenti Evropian (Tabela 5) mbetet numerikisht pro-zgjerimit, pasi tre grupet kryesore (EPP, S&D dhe Renew, me rreth gjysmën e ulëseve) e mbështesin procesin si instrument stabiliteti dhe demokracie, por pesha në rritje e grupeve euroskeptike dhe nga ana tjetër sovraniste (PfE, ECR, ESN) pritet ta ashpërsojë

²³ Albania's parliamentary elections competitive and well run but lacked level playing field, international observers say. (n.d.). OSCE. <https://www.osce.org/odihr/elections/590610>

²⁴ Corruption perceptions - Transparency International in the European union | TheGlobalEconomy.com. (n.d.). TheGlobalEconomy.com. https://www.theglobaleconomy.com/rankings/transparency_corruption/European-union/

diskursin mbi kushtëzimin, veçanërisht për migracionin dhe sundimin e ligjit. Kjo do të thotë se rezolutat e Parlamentit Evropian për Shqipërinë mund të kalojnë, por me gjuhë më të fortë reformuese.²⁵

Në Këshill, ku vlejnë rregullat e unanimitetit, qëndrimet janë të shpërndara sipas tre zonave (Tabela 6). Një bërthamë e fuqishme mbështetëse udhëhiqet nga Gjermania, Italia, Polonia, Portugalia, Kroacia dhe Sllovenia, të cilat e shohin integrimin si mjet stabilizimi rajonal dhe si faktor gjeoekonomik. Një rreth i dytë, ku bëjnë pjesë Franca, Holanda, Bullgaria, Sllovakia dhe Çekia, kërkojnë prova më të prekshme në luftën kundër korrupsionit, reformën e drejtësisë dhe administratën publike. Rrethi i tretë mban pozicion më neutral ose skeptik, Spanja, Qiproja, Malta, Hungaria, për arsye që variojnë nga çështja e Kosovës deri tek debati mbi migracionin. Holanda ka përdorur veto në të kaluarën (2018), ndërsa bllokime të mundshme nga Hungaria nuk përjashtohen, veçanërisht nëse çështjet e migracionit politizohen.

Për ta çuar dosjen përpara, Shqipëria duhet të ndjekë një strategji të dyfishtë, të shpejtojë rezultatet e matshme në sundimin e ligjit, transparencën financiare dhe reformën e administratës publike, ndërkohë që intensifikon diplomacinë dypalëshe, duke mobilizuar diasporën dhe sektorin privat për të korigjuar perceptimin në kryeqytetet skeptike. Vetëm një rekord i besueshëm reformash, i shoqëruar nga komunikim i qartë i përfitimeve të zgjerimit për Unionin, mund të zhbllokojë konsensusin në Këshill dhe të ulë skepticizmin në Parlamentin evropian.

Në këtë prizëm, rruga e Shqipërisë drejt BE-së mbetet sfiduese, por jo e pakapërcyeshme. Ritmi do të varet nga aftësia për të konvertuar rekomandimet në akte konkrete, për të prodhuar vendime gjyqësore të formës së prerë për korrupsion të nivelit të lartë dhe për të mbyllur

²⁵ The political groups. (n.d.). The Political Groups. <https://www.europarl.europa.eu/about-parliament/en/organisation-and-rules/organisation/political-groups>



hendekun ekonomik me reformat strukture qe kerkon tregu i perbashket.

Tabela 3. Indeksi i Demokracisë për Shqipërinë (2020–2024)

Viti	Rezultati total	Renditja globale	Procesi zgjedhor dhe pluralizmi	Funksionimi i qeverisë	Pjesëmarrja politike	Kultura politike	Liritë civile	Lloji i regjimit
2024	6.35	63	7.0	6.7	4.65	5.85	7.25	Demokraci me të meta
2023	6.29	65	7.0	6.6	4.6	5.8	7.2	Demokraci me të meta
2022	6.14	67	7.0	6.5	4.5	5.7	7.1	Demokraci me të meta
2021	6.11	68	7.0	6.43	4.44	5.63	7.06	Demokraci me të meta
2020	5.89	79	7.0	5.36	4.44	5.0	7.65	Regjim hibrid

Burimi: The Economist Intelligence Unit

Tabela 4. Indeksi i Lirisë – Shqipëria (Freedom House, 2020–2024)

Year / Viti	Political Rights / Të Drejtat Politike	Civil Liberties / Liritë Civile	Total Score / Pikët totale	Status / Statusi
2024	28/40	40/60	68/100	Partly Free / Pjesërisht i lirë
2023	28/40	39/60	67/100	Partly Free / Pjesërisht i lirë
2022	28/40	39/60	67/100	Partly Free / Pjesërisht i lirë

2021	27/40	39/60	66/100	Partly Free / Pjesërisht i lirë
2020	27/40	40/60	67/100	Partly Free / Pjesërisht i lirë

Burimi: Freedom House

Tabela 5. Përbërja dhe qasja ndaj zgjerimit në Parlamentin Europian (2024–2029)

Grupi Politik	Orientimi politik	Numri i vendeve (MEPs)	Qasja ndaj zgjerimit
EPP – Partia Popullore Evropiane	Qendra-Djathtas	188	Pro-zgjerimit, me fokus te reformat, mbështet Ballkanin
S&D – Socialistët & Demokratët	Qendra-Majtë	136	Mbështet zgjerimin si instrument stabiliteti dhe demokracie
PfE – Patriotët për Evropën	Djathtë populiste	84	Kundër zgjerimit, anti-migracion, sovranist
ECR – Konservatorë/Reformistë	Djathtë euroskeptik	78	Skeptik, kërkon kushte të ashpra për zgjerim
Reneë Europe – Liberalët	Qendër/Liberal	77	Pro-zgjerim, veçanërisht për avancim ekonomik dhe demokratik
Greens/EFA – Të Gjëlurit	Majtë/Ambientalistë	53	Pro-zgjerim me kushtëzime mbi klimën dhe demokracinë
The Left – Majta Ekstreme	Majtë ekstreme	46	Pro-zgjerim, por kritik ndaj neoliberalizmit
ESN – Europa e Kombeve Sovrane	Ekstrem Djathtë	25	Kundër zgjerimit, ultra-sovraniste
Të pafiltruar / të tjerë	—	33	Divers – ndikim direkt minimal ndaj politikave të zgjerimit

Burimi: Parlamenti Europian

Tabela 6. Qëndrimet e vendeve të BE-së ndaj Shqipërisë

Shteti anëtar	Qëndrimi ndaj Shqipërisë
Austria	Mbështet integrimin, por kërkon përmirësim në sundimin e ligjit
Belgjikë	Pro-zgjerim, nxit reforma
Bullgari	Mbështet, por me kushte për minoritetet
Kroaci	Mbështetje e fortë – eksperiencë si vend i fundit i anëtarësuar
Qipro	Neutral – preferon reforme të brendshme
Republikë Çeke	Pro-zgjerim me fokus te sundimi i ligjit
Danimarkë	Përshëndet procesin, pamjaftueshëm për reformat
Estoni	Mbështet reformën dhe integrimin
Finlandë	Mbështet stabilitetin rajonal
Franca	Mesatare; Macron propozon "rreth jashtë BE-së" për shtetet e reja
Gjermani	Mbështetëse e fortë – përkrah Berlinit Pro-Balkan
Greqi	Pro përfshirje, marrëveshje historike me Shqipërinë
Hungari	Ekstremiste/djathtë; fokus mbi migracionin
Irlandë	Mbështet integrimin demokratik
Itali	Mbështetje e fortë, përfshirë politika migracioni në Shqipëri
Letoni	Pro-zgjerim, deklarata zyrtare për mbështetje të Shqipërisë
Lituani	Mbështet reformimin dhe integrimin
Luksemburg	Mbështet demokracinë dhe zgjerimin
Malta	Mbështet progressive, por kërkon stabilitet
Holandë	Skeptike; ka bllokuar negociatat për shkak të korrupsionit
Poloni	Mbështetëse; krahasim me trajtimet ndaj vendeve të Evropës Lindore
Portugali	Përkrahëse e fortë; Presidenti lider i Këshillit
Rumania	Mbështet fuqishëm – politika e fqinjësisë
Slovakia	Mbështet me kusht – kërkon reforma
Sloveni	Mbështetëse, përvoja e shpejtë e ribashkimit
Spanjë	Neutral; kërkon konsensus mbi Kosovën, por nuk është kundër
Suedi	Mbështet zgjerimin demokratik
Çeki (Czechia)	Synon përmirësime ligjore përpara mbështetjes

- **Mbështetje e fortë:** Gjermani, Itali, Poloni, Portugali, Slloveni, Kroaci janë shume pro, duke ndihmuar Shqipërinë me reformën dhe praktikat.
- **Mbështetje me kusht:** Francë, Holandë, Bullgari, Sllovakia dhe Çekia kërkojnë reforma të thella për drejtësi dhe reformat administrative.
- **Skeptik/Neutral:** Spanjë, Hungari (me qasje ekstremiste), Qipro, Malta qëndrime rezervë.
- **Bllokues aktivë:** Holanda (kishte veto në 2018) dhe Hungaria mund të pengojnë vendime pa kushte të plotësuar.

7. Analiza e skenarëve për peridhën 2027-2030

Shqipëria ka hapur katër nga gjashtë grup-kapitujt tematikë të metodologjisë së re të negociatave: “Themelorët” (Cluster 1), “Marrëdhëniet me Jashtë” (6), “Tregu i Brendshëm” (2) dhe “Konkurrueshmëria & Rritja” (3), ndërsa “Afhenda e Gjellbër & Lidhjet e Qëndrueshme” (4) dhe “Bujqësia, Burimet & Kohezioni” (5) pritet të çelen deri në fund të 2025-ës . Shumica e kapitujve individualë vlerësohen ende me notat **2** (njëfarë përgatitjeje) ose **3** (përgatitje mesatare), me një përmirësim mesatar prej vetëm 0,5 pikësh në pesë vjet . Pengesat kyçe mbeten numri i ulët i dënimeve të nivelit të lartë për korrupsion dhe kapacitetet e kufizuara të administratës për të përthithur fondet IPA, si edhe në renditjen e dobët të Shqipërisë në indeksin e “Transparency International” (vendi 80/180, 2024) demokraci me të meta. Gjithashtu bazohemi tek rrugtimi i vendeve të tjera të rajonit, Kroacia ishte përjashtim, mbylli të gjithë kapitujt në 6 vjet, por me mbështetje politike të pakushtëzuar nga BE dhe pa “veto” aktive. Mali i Zi dhe Serbia janë shembulli standard i Ballkanit, edhe pse me negociata të hapura prej një dekade, kanë mbyllur shumë pak kapituj. Shqipëria ende s’ka mbyllur asnjë kapitull dhe ka një nivel

përgatitjeje mesatare 2-3 nga 5, gjë që vështirëson mbylljen masive përpara se të arrijnë rezultate të prekshme në kapitullin. 23/24.²⁶

Qasja metodologjike: Për t'i dhënë përgjigje pyetjes kërkimore të kapitullit "Sa reale është mbyllja e negociatave ne 2027 dhe anëtarësimi deri më 2030?", janë identifikuar dy pasiguri strategjike:

1. Ritmi i reformave të brendshme (sundimi i ligjit, depolitizimi administrativ, kapaciteti absorbues).
2. Klima politike në BE (kondicionaliteti (kushtëzimi) i shteteve anëtare skeptike, pesha e grupeve euroskeptike në Parlamentin Evropian).

Kombinimi i tyre prodhon tre trajektore të dallueshme, të cilat ofrojnë kornizën analitike për periudhën 2025-2030.

Skenari "Përsheptimi" (optimist)

Nëse qeveria paszgjedhore e 2025-ës arrin një konsensus të gjerë politik, finalizon paketën antikorruption dhe siguron dënime të formës së prerë në kapitujt 23/24, ndërsa BE-ja aktivizon mekanizmin "Reform & Growth Facility" për Ballkanin Perëndimor, procesi mund të përshpejtohet ndjeshëm. Të gjashtë grup-kapitujt hapen brenda vitit 2025, deri në fund 2027 mbyllen përkohësisht rreth 12–14 kapituj, ndërsa 10–12 të tjerë deri në 2029. Për kapitujt e mbetur, Shqipëria negocion afate 10-vjeçare zbatimi pas anëtarësimit. Faktorët gjeopolitikë sidomos lufta Ukrainë-Rusi dhe pozicioni strategjik i vendit në Ballkan mbeten përcaktues. Komisioni Evropian jep rekomandim pozitiv për Traktatin e Anëtarësimit, duke e zhvendosur ratifikimin në vitet 2030–2031. Përfitimet e menjëhershme janë rritja e aksesit në fondet strukturore dhe stabilizimi i pritshmërive të investitorëve. Rreziku kryesor lidhet me aftësinë institucionale për të absorbuar volumet shtesë të fondeve.

²⁶ European Commission (2024). Communication on EU Enlargement Policy- Albania 2024 Report. Brussels, SWD(2020) 690 final

Skenari “Ritëm Mesatar” (realist)

Ritmi i reformave mbetet i qëndrueshëm, por i moderuar, dënimet ndaj zyrtarëve të lartë për korrupsion janë ende sporadike dhe depolitizimi i administratës përparon me hapa të kujdesshëm. Shqipëria hap dy grup-kapitujt e mbetur deri në dhjetor 2025, mbyll provizorisht 6–8 kapituj deri në fund 2027 dhe 6–10 të tjerë deri në 2029. Komisioni sinjalizon mundësinë e anëtarësimit në horizontin 2033–2035, kushtëzuar me progres të vazhdueshëm në kapitujt 23/24 dhe 27. Ky variant përputhet më mirë me kapacitetet aktuale administrative dhe me lodhjen e pjesshme ndaj zgjerimit në disa vende anëtare të BE-së.

Skenari “Stanjacioni” (pesimist)

Mungesa e progresit në të grupkapitullit të parë dhe skepticizmi i disa vendeve anëtare ngadalësojnë procesin. Deri në dhjetor 2027 mbyllen përkohësisht vetëm 2–4 kapituj, ndërsa deri në 2029 hapen 4–6 kapituj. Komisioni vendos kriteret shtesë dhe mund të pezullojë fondet IPA apo “Growth Plan” (politika e “shkopit dhe karrotës”). Për pasojë, perspektiva e anëtarësimit shtyhet përtej 2036; emigracioni i të rinjve dhe pasiguria e investitorëve rriten ndjeshëm. Ky skenar nënvizon kostot e mospërmbyshjes së kushteve kryesore si sundimin e ligjit, transparencën fiskale dhe depolitizimin e administratës.

Të tria skenarët tregojnë se mbyllja e negociatave deri në 2027 dhe anëtarësimi para 2030 varen kryesisht nga performanca në kapitujt 23/24 dhe nga aftësia e qeverisë për të kaluar nga miratimi ligjor te rezultatet e matshme. Po aq vendimtare është aftësia negociuese për të siguruar afate tranzitore 10-vjeçare në kapitujt teknikë, ku kapacitetet vendore janë të kufizuara. Sipas të dhënave aktuale, skenari më i besueshëm mbetet skenari “Ritëm Mesatar”, ku negociatat zgjasin përtej pragut 2030, por ruhet trendi progresiv i integritetit. Komisioni pritet të japë rekomandim pozitiv për Traktatin e Anëtarësimit në vitet 2030–2032, me anëtarësim të plotë të mundshëm në 2033–2035. Megjithatë, rreziku i vetos nga ndonjë shtet anëtar vazhdon të jetë një sfidë kyçe.

8. GJETJET KRYESORE

Kapitujt dhe progresi : Shqipëria ka hapur 4 nga 6 grup-kapitujt, por shumica e kapitujve individualë marrin ende nota 2 (njëfarë përgatitje) ose 3 (përgatitje mesatare), me një përmirësim mesatar vetëm 0,5 pikë gjatë 2020-2024. Përfundim bën grup-kapitulli 6 "Politika e Jashtme dhe Siguria", i vlerësuar me notën 4 falë linjimit me BE-në. Nga ana tjetër, grup-kapitujt 4 "Afhenda e gjelbër dhe lidhjet e qëndrueshme" dhe 5 "Bujqësia, burimet dhe kohezioni" mbeten të paçelur e vlerësohen me notën 2, duke sinjalizuar sfidat kryesore të ardhshme. Kjo tregon se, megjithë hapjen formale të negociatave, progresi thelbësor mbetet i kufizuar dhe i pabarabartë midis fushave. Hapja e kapitujve është vetëm një hap i parë, ndërsa mbyllja e tyre kërkon reforma të thella dhe zbatim të qëndrueshëm. E ardhmja e Shqipërisë, pra, varet nga aftësia e saj për të kombinuar reformat dhe hapjen politike për të shmangur një ndryshim të ngjashëm dhe për të siguruar realizimin e pranimet të saj në BE.

Faktorët që ndikojnë ne proces: Faktorët e brendshëm si korrupsioni i lartë, polarizimi politik dhe administrata ende e politizuar pengojnë avancimin e kapitujve 23/24 dhe ulin kapacitetin për të përthithur fondet IPA. Përparimi ekonomik ngadalësohet nga borxhi i lartë publik dhe produktiviteti i ulët, ndërsa reformat gjyqësore mbeten të brishta. Faktorët e jashtëm si, "lodhja nga zgjerimi" në disa vende të BE-së, rritja e forcave euroskeptike në Parlamentin Evropian dhe sistemi i vetos në Këshill shtojnë kushtëzimin politik.

Skenarët deri më 2027: Skenari optimist "Përsheptimi" vlerëson hapjen e dy grup-kapitujve të mbetur deri në 2025 dhe mbylljen provizore të rreth 12-14 kapitujve deri në fund 2027, nëse Shqipëria prodhon dënime të nivelit të lartë për korrupsion dhe BE zbaton fondin e ri të rritjes. Skenari bazë " Ritëm Mesatar " llogarit mbylljen e vetëm 6-8 kapitujve deri më 2027, duke e shtyrë anëtarësimin real në horizontin 2033-2035. Në variantin pesimist "Staniacioni ", ngecja në kapitujt 23/24 dhe

skepticizmi i disa shteteve anëtare do ta shtynin çdo perspektivë pas 2035, me rrezik ndërprerjeje fondesh dhe rritje emigracioni. Probabiliteti më i lartë, bazuar në ritmin aktual, mbetet skenari i “ Ritëm Mesatar ”. Sipas fakteve të deritanishme dhe skenarit më të besueshëm “Ritëm Mesatar”, ritmi real i reformave dhe klima e zgjerimit në BE nuk e përkrahin dot një kalendar kaq ambicioz. Pavarësisht faktorëve gjeopolitikë që mund ta përshpejtojnë ose ngadalësojnë procesin, në planin teknik të transpozimit të legjislacionit të BE-së dhe zbatimit të tij në praktikë, Shqipëria ende duhet të përmbushë plotësisht standardet europiane. Për këtë arsye, premtimi për mbylljen e negociatave në 2027 dhe anëtarësimin e plotë në 2030 mbetet kryesisht retorikë elektorale, jo objektiv strategjik i mbështetur në analizë të mirëfilltë.

9. REKOMANDIMET

- 1. Konsolidim i sundimit të ligjit:** Përsheptimi i hetimeve dhe dënimeve të formës së prerë për korrupsion të nivelit të lartë është kushti themelor për kapërcimin e kapitujve 23/24. Vetëm një bilanc gjyqësor i besueshëm do t'i japë kredibilitet kërkesës për mbylljen e parë provizore të kapitujve.
- 2. Hapja dhe avancimi i grup-kapitujve “Gjelbër” dhe “Bujqësi”:** Miratimin e strategjisë kombëtare për zonat e mbrojtura dhe planin e transportit të qëndrueshëm, që të shmanget pengesa nga amendamentet e 2024-ës mbi parqet natyrore. Çelja e grup-kapitujve 4 dhe 5 brenda 2025-ës do të plotësonte hartën negociuese dhe do të balanconte narrativën e progresit.
- 3. Rritja e kapacitetit për thithjen e fondeve :** Depolitizimi i administratës dhe rekrutimi i stafit të specializuar auditimi për të minimizuar rrezikun e pezullimit të projekteve rajonale. Kjo do të ulte hendekun financiar me Malin e Zi dhe do të forconte besimin e donatorëve.
- 4. Diplomacia dy-palëshe me “bërthamën mbështetëse” të BE-së:** Intensifikoni angazhimin në kryeqytetet pro-zgjerimit (Gjermani, Itali, Poloni, Portugali, Slloveni) duke paraqitur rezultate konkrete. Kombinimi i progresit teknik me lobimin politik mund të neutralizojë vetot potenciale dhe të përsheptojë mbylljen e kapitujve kyç .

10. REFERENCAT

Albania's parliamentary elections competitive and well run but lacked level playing field, international observers say. (n.d.). OSCE.

<https://www.osce.org/odihr/elections/590610>

Cluster 1 Albania – Cluster One EU Negotiations Platform – Albania (C1-EU-NPA). (n.d.). <https://cluster1albania.com/>

Commission Européenne (2010). Avis de la Commission sur la demande d'adhésion de l'Albanie à l'Union européenne ,Bruxelles, le 9.11.2010 COM(2010) 680 final

Corruption perceptions - Transparency International in the European union | TheGlobalEconomy.com. (n.d.). TheGlobalEconomy.com. https://www.theglobaleconomy.com/rankings/transparency_corruption/European-union/

Élargissement de l'UE. (2022, 25 juin). European Council <https://www.consilium.europa.eu/fr/policies/enlargement/#:%7E:text=Qu'est%2Dce%20que%20l,de%20conditions%20politiques%20et%20%C3%A9conomiques>

European Commission (2014). Communication on EU Enlargement Policy- Albania 2014 Report. COM(2014)700 final of 8.10.2014.

European Commission (2020). Communication on EU Enlargement Policy- Albania 2020 Report. Brussels, 6.10.2020 SĚD(2020) 354 final

European Commission (2021). Communication on EU Enlargement Policy- Albania 2021 Report. Strasbourg, 19.10.2021 SĚD(2021) 289 final

European Commission (2022). Communication on EU Enlargement Policy- Albania 2022 Report. Brussels, SĚD(2020) 332 final

European Commission (2023). Communication on EU Enlargement Policy- Albania 2023 Report. Brussels, SĚD(2020) 690 final

European Commission (2024). Communication on EU Enlargement Policy- Albania 2024 Report. Brussels, SĚD(2020) 690 final

Freedom House. (n.d.). Albania. In *Freedom House*.

<https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2024>

Guyader, M. (2007), "Élargissements et intégration dans l'Union. ", *Politique étrangère*, (2), p.372.

Koutsokosta, E. (2021, 11 mai). *Splitting EU membership bids of North Macedonia and Albania « not possible »*. Euroneës. Consulté le 23 novembre 2021, à l'adresse <https://ëëë.euroneës.com/my-europe/2021/05/10/not-possible-to-decouple-eu-bids-of-north-macedonia-and-albania-says-zaev>

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (2020). Marrëdhëniet Shqipëri-BE <http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/anetaresimi-ne-be/historiku/>

Rreth negociatave - Integrimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian. (2020, May 5). Integrimi i

Republikës Së Shqipërisë Në Bashkimin Europian. <https://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/negociatat/rreth-negociatave/>

The political groups. (n.d.). The Political Groups.

<https://ëëë.europarl.europa.eu/about-parliament/en/organisation-and-rules/organisation/political-groups>

TRADING ECONOMICS. (n.d.). *Albania Corruption Index*.

<https://tradingeconomics.com/albania/corruption-index>

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al